



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Pranuar - Primijsano Me/Dana *05.12.2012*

Nr. l organit Org.broj	Numri/Broj	Shtojca Prilog	Vlera Vendoset
<i>01</i>	<i>013/392</i>		

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 40.2 pika 1 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35.2 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 20.11.2012, aprovon këtë:

V E N D I M

PËR BARTJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË PALUAJTSHMËRISË (TOKË) NË PRONËSI SHOQËRORE PRONË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË NË SHFRYTËZUESIN E PËRKOHSHËM BASHKËSIA ISLAME NË VITI PËR OBORRIN E XHAMISË MË FSHATIN KABASH

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, bënë caktimin dhe bartjen administrative të së drejtës së shfrytëzimit të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme (tokës) e cila evidentohet në ngastrën kadastrale nr 632-1, lloji i pronës Parcelë, zona u/r Unknown, vendi i quajtur "FSHAT", në sipërfaqe prej 3306m² Zona Kadastrale Kabash, nga pronari i më parshëm pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal në Viti, në bartësin e ri shfrytëzuesin e përkohshëm Bashkësia Islame në Viti-oborrin e xhamisë në fshatin Kabash.

Neni 2

Bartja administrative e të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme nga neni 1 i këtij vendimi bëhet pa kompensim, duke u bazuar në kërkesën me nr 07-16/1374 të datës 21.08.2012 të Këshillit të fshatit Kabash drejtuar Drejtorisë për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë.

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë, obligohet që të bëjë ndërrimin në regjistrin kadastral në emër të shfrytëzuesit të ri.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Kadastër
2. Këshillit të fshatit Kabash
3. Arkivit



KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibi

Skenderbe Hebibi